



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



UDHËZUES PËR MËSUESIN KUJDESTAR

Në ndihmë të zhvillimit të orëve të kujdestarisë për trajtimin e temave mbi parandalimin e fenomenit të kstremizmit të dhunshëm në shkollat e mesme

TETOR, 2018

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

E drejta e autorit për këtë publikim është e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë.

PËRMBAJTJA

I. TË DREJTAT E NJERIUT DHE TOLERANCA	5
Çfarë kuptojmë me të drejtat e njeriut?	5
Çfarë është një shkollë që përkrah të drejtat e njeriut?	6
Çfarë kuptojmë me tolerancë?.....	7
ORGANIZIMI I ORËVE PËR TEMËN “TË DREJTAT E NJERIUT DHE TOLERANCA”.....	7
Në përfundim të dy orëve, mësuesi bën konkluzionet dhe falënderon nxënësit për punën dhe kontributin e tyre.....	11
II. SIGURIA NË SHKOLLË.....	12
ORGANIZIMI I ORËVE PËR TEMËN “SIGURIA NË SHKOLLË”	14
III. BULLIZMI, SJELLJE ANTISOCIALE QË ÇON NË DHUNË.....	16
Çfarë është bullizmi?.....	16
Nga ndryshon bullizmi nga dhuna?.....	17
Cilat janë llojet e bullizmit?	17
Cilat janë tiparet e nxënësve që janë viktime të bullizmit?.....	18
Cilat janë tiparet e bullistit?	19
Pasojat e bullizmit	19
Si mund ta parandalojmë dhe ta luftojmë bullizmin në shkollë?	20
Këshilla për mësuesit	21
IV. EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE RADIKALIZMI	30
“Rrugëtimi” psikologjik i zhvillimit të ideologjive që justifikojnë ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin.....	31
Perceptim i përjashtimit shoqëror dhe marginalizimi	32
Kquadri ligjor dhe institucional në Shqipëri	32
Qëllimi i strategjisë kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.....	32
Fushat për zhvillimin e kapaciteteve, politikave dhe mekanizmave për t’u përballur me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin	33
Strategjitë e parandalimit dhe të adresimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe të radikalizmit.....	33
Komunikimi	33
Dëgjimi aktiv	33
Perifrazimi.....	34
Drejtimi i pyetjeve	35
Ndërtimi i një strategjie komunikimi dhe edukimi kundër ekstremizmit të dhunshëm.....	36
ORGANIZIMI I ORËVE PËR TEMËN “EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE RADIKALIZMI”	36
Shtojca 1.....	41

FALËNDERIM

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori) në kuadër të skemës së granteve të vogla të projektit *“Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Rritjen e Reziliencës së të Rinjve ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm”* i financuar nga Bashkimi Europian dhe i zbatuar nga Terre des Hommes Shqipëri falënderon të gjithë aktorët që kontribuan në realizimin e këtij dokumenti, *“Udhëzues për mësuesin kujdestar (Në ndihmë të zhvillimit të orëve të kujdestarisë për trajtimin e temave mbi ekstremizmin e dhunshëm)”* si më poshtë:

- ❖ Në radhë të parë falënderojmë Bashkimin Europian që mundësoi financiarisht realizimin e Udhëzuesit, si dhe Terre des Hommes - Albania si koordinator kombëtar.
- ❖ Falënderojmë ekspertët e arsimit që ndihmuan profesionalisht në realizimin e udhëzuesit, si dhe DAR Elbasan, ZAKamëz dhe ZA Pogradec për bashkëpunimin.
- ❖ Falënderojmë drejtuesit, psikologët dhe stafin arsimor të tri shkollave të mesme pilot (Mahmud dhe Ali Cungu” në Elbasan, “Dëshmorët e Pojskës” në Hudënisht, Pogradec, si dhe “Ibrahim Rugova” në Kamëz) në zbatimin e projektit *“Shkollat si kundërshtarë të vijës së parë të ekstremizmit të dhunshëm”*, të cilët e pasuruan këtë dokument me mendimet e sugjerimet e tyre.
- ❖ Falënderojmë nxënësit e shkollave pilot që u bënë pjesë e aktiviteteve të projektit duke na përcjellë mendimet e tyre të vlefshme në hartimin e udhëzuesit.
- ❖ Falënderojmë punën e stafit të Observatorit që bashkoi kontributin e të gjithë aktorëve në realizimin e udhëzuesit.

HYRJE

Partnerë të MASR-së dhe OJF, të interesuara për mbarëvajtjen e punës në shkolla japin ndihmesën e tyre për një klimë pozitive dhe atmosferë miqësore në shkollë. Edhe komunitetet e shkollave po tregojnë interes të veçantë dhe po bashkëpunojnë përditë e më shumë me mësuesit për një proces mësimor normal dhe për rritjen e cilësisë së shërbimit arsimor.

Rol të veçantë dhe të pazëvendësueshëm në krijimin e një mjedisi të ngrohtë e miqësor në shkollë dhe në parandalimin e sjelljeve të ekstremizmit të dhunshëm luan mësuesi kujdestar i klasës. Tashmë dihen vështirësitë e punës së mësuesit kujdestar, mbi të cilin bie barra e rëndë e kujdesit për një klasë të tërë, me përbërje heterogjene, me individë me formim, prejardhje e karakter të ndryshëm.

Mësuesi kujdestar gjen në këtë udhëzues modele të trajtimit të disa temave që lidhen me fëmijët, si dhe me të drejtat dhe problemet e ndryshme që hasin ata në shkollë dhe kudo.

Sipas Dispozitave Normative 2013, të ndryshuara, *“Mësuesi zhvillon të paktën 6 orë të kujdestarisë në një vit shkollor sipas një plani të hartuar në bashkëpunim me këshillin e prindërve të klasës. Në orët e kujdestarisë përfshihen dhe takimet me të gjithë prindërit e klasës bashkë me nxënësit.”* (DN 2013, pika 6, neni 84 “Mësuesi kujdestar i klasës”). Planin vjetor të orëve të kujdestarisë, mësuesi e paraqet për miratim te drejtori/nëndrejtori i shkollës. Mësuesi i shënon orët e kujdestarisë në faqen e posaçme të regjistrit të klasës. Ai mban rregullisht plan ditor për orët e kujdestarisë dhe ky plan ditor është objekt i inspektimit. Sipas DN-ve, orët e kujdestarisë vendosen në orarin javor të shkollës (pika 8.b., e nenit 84). Këtu është vendi të sqarohet se bëhet fjalë vetëm për gjashtë a më shumë orët e kujdestarisë, të planifikuara dhe të miratuara, dhe jo për të 72 orët vjetore të mësuesit kujdestar që janë pjesë e normës mësimore javore, siç përcaktohet në Udhëzimin e MAS-it nr. 44, datë 16.10.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e MASH-it nr. 21, datë 23.07.2010, “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit para universitar”.

Në grupin e orëve të kujdestarisë, të planifikuara dhe të miratuara, mësuesi kujdestar mund të përfshijë edhe temat e zërthyera në Udhëzuesin tonë. Kjo do t'i lehtësonte shumë punën mësuesit kujdestar për të trajtuar me kompetencë e mjeshtëri dukuri që takohen shpesh në mjediset e shkollave tona, siç janë: shkeljet e të drejtave të njeriut, bullizmi, sjelljet e ekstremizmit të dhunshëm, krijimin e mjediseve të sigurta etj., si dhe për të parandaluar dhe për të zgjidhur me profesionalizëm raste me të cilat mund të përballlet në klasën apo në

vendin e punës. Që mësuesi kujdestar i klasës të arrijë pritshmëritë e tij në lidhje me klimën miqësore në klasë e në shkollë, ai duhet të bashkëpunojë e bashkëveprojë ngushtë me kolegët e tjerë, me drejtuesit e shkollës, me psikologun/punonjës social, me prindërit e nxënësve, me komunitetin në tërësi, si dhe me çdo partner që ka kapacitete të mjaftueshme për formimin e sjelljeve miqësore të nxënësit në arsimin parauniversitar.

Udhëzuesi përmban katër tema dhe secila prej tyre mund të trajtohet në dy orë kujdestarie. Gjithçka varet nga kushtet e klasës që ka në kujdestari mësuesi dhe nga problematikat që mund të lindin gjatë vitit shkollor, ndaj plani i orëve të kujdestarisë nuk është plan që nuk ndryshohet; ai duhet parë me fleksibilitet nga mësuesi dhe drejtuesit e shkollës. Metodologjia e zhvillimit të temave është një alternativë. Mësuesi është i lirë ta pasurojë, ta ndryshojë dhe ta zbatojë atë në mënyrë krijuese, sepse, një dukuri që ndodh në një klasë, nuk është e shkallës së njëjtë me po atë dukuri që mund të ndodhë në një klasë tjetër. Natyra dhe shkalla e dukurisë e orientojnë mësuesin për strategjinë që ai do të përdorë, në mënyrë që veprimtaria që do të zhvillojë, të jetë efektive dhe të japë rezultatet e pritshme.

Çdo temë është e organizuar në dy pjesë. Në pjesën e parë është dhënë një informacion teorik për mësuesin, ndërsa në pjesën e dytë është dhënë struktura e dy orëve që mund të zhvillojë mësuesi me klasën në kujdestari.

Sugjerimet dhe vërejtjet që do të kenë mësuesit nga përvoja e tyre gjatë zbatimit të Udhëzuesit, do të vlerësohen për përmirësimin e tij, në mënyrë që ai të shërbejë edhe më mirë si një dokument dhe mik ndihmës i mësuesit kujdestar në arsimin e mesëm të lartë.

Në realizimin e këtij udhëzuesi jemi mbështetur në Strategjinë Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm 2014 – 2020, në udhëzuesin e UNESCO-s për mësuesit në drejtim të parandalimit të fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm dhe në trajnimin e trajnerëve organizuar në vitin 2017 nga Qendra e Koordinimit të Ekstremizmit të Dhunshëm në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) në kuadrin e një programi të USAID-it.

I. TË DREJTAT E NJERIUT DHE TOLERANCA

Edukimi për të drejtat e njeriut është detyrim i shkollës, jo vetëm për të përmbushur detyrimin e shtetit e të shoqërisë për të respektuar të drejtat e fëmijëve, por edhe për të krijuar një mjedis të sigurt dhe nxitës për të nxëniet. Fushata e fundit e Këshillit të Europës “I lirë për të folur, i sigurt për të nxënë” e konsideron shkollën si vendin që promovon lirinë e fjalës dhe të shprehjes, gjithëpërfshirjen, tolerancën etj.

Shkolla konsiderohet si aktori kryesor për t’u marrë me rreziqet dhe sfidat ndaj shoqërisë. Ajo ka detyrimin të trajtojë, ndër të tjera, faktorët që e cenojnë (ose krijojnë kushtet për ta cenuar) lirinë e fjalës në shkollë dhe për të ulur veprimin e këtyre faktorëve. Këta faktorë lidhen me rritjen e diversitetit (kulturor, botëkuptimor etj.) dhe me dimensionet e reja që i janë shtuar këtij diversiteti sot si p.sh.: ekstremizmi i dhunshëm. Shkolla ka për detyrë të krijojë mjedisin frenues ndaj dukurive të ekstremizmit.

Çfarë kuptojmë me të drejtat e njeriut?

Përkufizimet e të drejtave të njeriut janë të ndryshme. Ajo që mund të theksojmë lidhet me faktin se të drejtat e njeriut janë të barabarta për të gjithë qeniet njerëzore. Ato janë universale, në kuptimin që janë të zbatueshme kudo dhe në çdo kohë.

Të drejtat e njeriut në përgjithësi mund të përcaktohen si ato të drejta që kanë të bëjnë me natyrën tonë dhe pa të cilat ne nuk mund të jetojmë si qenie njerëzore.

Të drejtat e njeriut janë të drejta të qenësishme për të gjitha qeniet njerëzore, pavarësisht nga raca, gjinia, kombësia, përkatësia etnike, gjuha, feja apo ndonjë status tjetër. Të mbrosh të drejtat e njeriut do të thotë të respektosh dinjitetin njerëzor të çdo personi.

Parimet e të drejtave të njeriut mbështesin vizionin e një bote të lirë, të drejtë dhe paqësore. Ato vendosin standarde minimale për mënyrën se si individët dhe institucionet kudo duhet t’i trajtojnë njerëzit.

Duhet konceptuar nga të gjithë se këto të drejta universale nuk mund t’i konsiderojmë si të ndara me njëra- tjetrën, sepse ato përmbushin dhe plotësojnë njëra- tjetrën. Të drejtat e njeriut përfshijnë të drejtën për jetë dhe liri, mbrojtje nga skllavëria dhe tortura, lirinë e mendimit dhe të shprehjes, të drejtën për punë dhe edukim e shumë të tjera.

Përpyekja për realizmin e vlerës universale të të drejtave të njeriut në tërë botën shënon një rrugëtim shumë të gjatë. Ideja e barazisë së të gjithë njerëzve është trajtuar që në filozofinë greke, para më shumë se 2000 vitesh. Pas përvojave të tmerrshme të Holokaustit dhe Luftës

së Dytë Botërore dhe mes varfërisë së tejskajshme që po përjetonte pjesa më e madhe e popullsisë në botë, shumë njerëz kërkuan hartimin e një dokumenti që do të mundësonte mbrojtje për të drejtat e çdo personi në botë dhe të siguronte një të ardhme më të mirë për njerëzimin. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR) u hartua për herë të parë në vitin 1948 nga Organizata e Kombeve të Bashkuara me synim përmbushjen e qëllimit të saj, vënia në jetë e të drejtave të njeriut (për t'u njohur me nenet e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut referojuni shtojcës 1.).

Deri tani u ndalëm në aspektin e përkufizimit mbi të drejta e njeriut. Tani do të ndalemi konkretisht se si ne të gjithë aktorët të nxitim tek nxënësit frymën e sjelljes qytetare dhe demokratike. Aftësia për të jetuar së bashku në frymën e tolerancës dhe të demokracisë pa dyshim që nuk mund të vijë në mënyrë të natyrshme. Nxënësit nuk mund të jenë të përjashtuar nga ky rreth vicioz i të drejtave. Ata duhet të rrisin aksesin dhe njohuritë e tyre për konceptin e të drejtave të njeriut dhe të kuptojnë më mirë se çfarë janë vlerat, si: dinjiteti, toleranca, mirëkuptimi, bashkëpunimi, mendimi kritik, pjesëmarrja, përfshirja etj.

Edukimi për të drejtat e njeriut me nxënësit është një proces i vazhdueshëm dhe që ka për qëllim të krijojë kulturën për të drejtat e njeriut. Procesi ndërtohet mbi pjesëmarrjen aktive të vetë nxënësve, përmes së cilës ata mësojnë për të drejtat e njeriut, fitojnë shkathtësi dhe aftësi për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe pa dyshim që zhvillojnë qëndrime ndaj respektit, dinjitetit njerëzor dhe barazisë. Duke jetuar me të tjerët brenda sistemit familjar, një komuniteti të caktuar dhe një shkollë të caktuar, nxënësit që në moshë relativisht të re duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të informuar për çështjet që lidhen me drejtësinë, sepse në këtë mënyrë krijojnë edhe perceptimin e tyre për shoqërinë dhe botën në tërësi.

Duke u ushqyer të kuptuarin dhe vizionin për të drejtave të njeriut, duke u formësuar opinionet dhe duke u zhvilluar qëndrimet, edukimi për të drejtat e njeriut e mbështet shumë fort këtë interes natyral të nxënësve.

Çfarë është një shkollë që përkrah të drejtat e njeriut?

Një shkollë që përkrah të drejtat e njeriut është ajo që i vendos të drejtat e nxënësve në qendër të përvojës së të nxënësve dhe i bën të drejtat e tyre një pjesë integrale të aktiviteteve në shkollë. Një shkollë e tillë bazohet në parimet e barazisë, dinjitetit, respektit, mos diskriminimit dhe pjesëmarrjes.

Ambientet e shkollës janë vendi ku të drejtat e njeriut mësohen, praktikohen, respektohen, mbrohen dhe promovohen. Shkollat që përkrahin të drejtat e njeriut janë mjedise

gjithëpërfshirëse ku të gjithë inkurajohen të jenë aktivë dhe të marrin pjesë në jetën e shkollës, pavarësisht nga statusi apo roli, si dhe ku promovohet diversiteti. Nxënësit dhe komuniteti i shkollës mësojnë për të drejtat e njeriut duke i vënë ato në praktikë çdo ditë.

Nga mënyra se si merren vendime në shkollë, se si nxënësit dhe mësuesit trajtojnë njëri-tjetrin, nga kurrikula e deri në aktivitetet sportive apo kulturore që zhvillohen, shkolla duhet të jetë modeli më shembullor për edukimin për të drejtat e njeriut .

Çfarë kuptojmë me tolerancë?

Tolerancë do të thotë të pajtohesh me dallimet. Kjo do të thotë të tregosh respekt për racën, fenë, moshën, gjininë, mendimet dhe ideologjitë e njerëzve apo të grupeve të tjera.

Një person mund të mos pajtohet plotësisht me të tjerët për çdo çështje, ndërkohë që i respekton ata me mendime të ndryshme dhe i trajton me dinjitet dhe respekt. Mosmarrëveshja nuk është e barabartë me mungesën e tolerancës.

Nganjëherë ky respekt është i njëanshëm. Ata që nuk pajtohen me një çështje të veçantë duhet të respektojnë mendimet e atyre që e mbrojnë atë, por disa që i përkrahin këto mendime ndihen të justifikuar në etiketimin e atyre që nuk pajtohen me terma fytes dhe anasjelltas. Të dyja palët duhet të jenë tolerante ndaj njëra-tjetrës.

Kur bëhet fjalë për çështje problematike, toleranca mund të shprehet gjithashtu duke mbajtur një qëndrim "le të bien dakord për të mos u pajtuar". Kjo nuk do të thotë që njëra prej palëve duhet të pranojë fjalët, veprimet ose idetë që janë kundër vlerave ose besimeve të tij, por do të thotë që çdo person pranon të respektojë të drejtën e tjetrit për të shprehur ndjenjat e tij në lidhje me këtë çështje. Kur të dyja palët kanë shprehur mendimet e tyre dhe është e qartë se asnjëra nga palët nuk do të ndryshojë pozicionin që mban, të biesh dakord për të mos u pajtuar, shpesh është rezultati më miqësor.

Në kontekstin arsimor dhe më konkretisht në mësimin ndërkulturor, koncepti nënkupton aftësinë për të dalluar pozitivisht dallimet kulturore, për të pranuar paqartësi të shumëfishta të krijuara nga takimet ndërkulturore, dhe për t'u marrë me konstruktivitetin dhe mësuar nga paqartësia që rezulton. Për këtë qëllim toleranca duhet edukuar gjatë gjithë periudhës shkollore.

ORGANIZIMI I ORËVE PËR TEMËN “TË DREJTAT E NJERIUT DHE TOLERANCA”

Rezultatet e pritshme nga trajtimi i kësaj teme.

Nxënësi:

- liston të drejtat e njeriut sipas Deklaratës Universale të të Drejtave të njeriut;
- diskuton mbi respektimin dhe shkeljen e të drejtave të njeriut në Shqipëri e në botë;
- analizon shkaqet e shkeljes së të drejtave të njeriut;
- merr pjesë në aktivitete për njohjen e të drejtave të njeriut;
- gjykon veprimet e tij dhe të të tjerëve në respektimin e të drejtave;
- vlerëson tolerancën si vlerë njerëzore

Metodat dhe teknikat mësimore: stuhi mendimi, kllaster, punë në grup, bashkëbisedim.

Koha mësimore: 2 orë mësimi (45 minuta + 45 minuta).

Hapi i parë

Çfarë do të thotë të jesh njeri?

Shkruani fjalët "NJERI" dhe "TË DREJTA" në krye të tabelës. Nën fjalën "NJERI" vizatoni një rreth ose skicë të një njeriu. Ftoni nxënësit të japin mendimet e tyre rreth cilësive që na bëjnë ne qenie njerëzore. Përgjigjet e nxënësve i shkruani brenda skicës. Për shembull: "inteligjenca", "simpatia", "humori", "imagjinata", "erotizmi" etj.

Kërkoni nga nxënësit që të japin mendimin e tyre rreth pyetjes:

- Çfarë është e nevojshme për të mbrojtur, rritur dhe zhvilluar plotësisht këto cilësi të një qenieje njerëzore. Rendisni përgjigjet e tyre jashtë rrethit dhe kërkoni nga nxënësit t'i shpjegojnë ato. Për shembull, "arsimi", "miqësia", "familja e dashur".

(*Shënim:* Ruajeni këtë listë për ta përdorur në pjesën e dytë)

Diskutoni me nxënësit:

- Çfarë do të thotë të jesh plotësisht njerëzor?
- Çfarë u duhet njerëzve për të jetuar me dinjitet?
- A janë të gjitha qeniet njerëzore në thelb të barabarta?
- Cila është vlera e dallimeve njerëzore?
- A mund të merren prej nesh cilësitë njerëzore "esenciale"? Për shembull, a jeni prapë njerëz nëse humbni të drejtën e fjalës?
- Çfarë ndodh kur një person ose qeveria përpiqet të privojë dikë nga diçka që është e nevojshme për dinjitetin e tij njerëzor?
- Çfarë do të ndodhte nëse duhet të hiqnit dorë nga një nga këto nevoja njerëzore?

Shpjegoni se gjithçka brenda rrethit ka të bëjë me dinjitetin njerëzor, tërësinë e të qenit njerëzor. Çdo gjë që shkruhet rreth skicës përfaqëson atë që është e nevojshme për dinjitetin njerëzor. Të drejtat e njeriut bazohen në këto nevoja.

Lexoni këto fjali nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR) dhe shpjegoni që ky dokument përcakton standardin se si njerëzit duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit në mënyrë që të respektohet dinjiteti njerëzor i të gjithëve:

... njohja e dinjitetit dhe e të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë ...

Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta. Ato janë të pajisur me arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të veprojnë ndaj njëri-tjetrit me një frymë vëllazërie.

Hapi i dytë

Çfarë është “E DREJTA”?

1. Ndani nxënësit në grupe ose ftojini në një bashkëbisedim, ku të japin idetë e tyre rreth kuptimit të të drejtave të njeriut dhe shkruani këto përgjigje në tabelë. Mundohuni të formoni një përkufizim rreth të drejtave të njeriut që të gjithë mund të pajtohen dhe shkruani në tabelë këtë përkufizim.

2. Shkruani në tabelë këtë përkufizim të të drejtave të njeriut:

Të drejtat e njeriut i përkasin të gjithë njerëzve pa marrë parasysh gjininë, racën, ngjyrën, gjuhën, kombësinë, moshën, klasën, fenë apo bindjet politike. Ato janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme dhe të ndërvarura. Çfarë nënkuptohet me universale? Po me të patjetërsueshme? Po me të pandashme? Po me të ndërvarura? Kërkojuni nxënësve t'i shikojnë këto terma në fjalor.

3. Shikoni përsëri listën e krijuar në pjesën e parë të aktivitetit (pika 2).

5. Shkruani në tabelë "MBIJETESË/EKZISTENCË", "DINJITET NJERËZOR", dhe "KOMODITET/LUKS". Diskutoni kuptimin e këtyre termave.

Shqyrtoni tabelën e ndërtuar gjatë pjesës së parë. Vendosni të gjitha këto përgjigje si nevoja për të zhvilluar plotësisht cilësitë njerëzore nën një nga titujt e mësipërm. Për shembull, a është arsimi i domosdoshëm për mbijetesë? A është i domosdoshëm për dinjitetin njerëzor? A është arsimi një komoditet apo luks?

6. Diskutoni:

- A konsiderohen të drejta të njeriut vetëm ato aspekte që një qenieje njerëzore i duhen për të mbijetuar? Pse po ose pse jo?
- A duhet që të drejtat e njeriut të mbrojnë ato gjëra që klasifikohen nën "komoditet/luks"? Pse po ose pse jo?
- Disa njerëz në botë kanë vetëm ato gjëra që janë të nevojshme për të mbijetuar, ndërsa të tjerët kanë gjëra që u ofrojnë atyre komoditet dhe luks. A është e drejtë kjo? A është kjo situatë shkelje e të drejtave të njeriut?
- A duhet të bëhet diçka? Nëse po, si dhe nga kush?

Hapi i tretë

Cila është e drejta universale?

Lexoni komentet e Eleanor Roosevelt, ish-kryetare e komisionit të OKB-së që ka hartuar DUDNJ, mbi rëndësinë e standardeve universale të të drejtave të njeriut:

“Ku, në fund të fundit, fillojnë të drejtat universale? Në vende të vogla, në afërsi të shtëpisë - aq afër dhe aq të vogla sa që nuk mund të shihen në ndonjë hartë të botës. Megjithatë ata janë: bota e çdo individit; lagja ku jeton; shkolla apo kolegji që ndjek; fabrika apo zyra ku punon. Të tilla janë vendet ku çdo burrë, grua dhe fëmijë kërkojnë drejtësi të barabartë, mundësi të barabartë, dinjitet të barabartë, pa diskriminim. Nëse këto të drejta nuk kanë kuptim atje, ato kanë pak kuptim kudo tjetër. Pa angazhimin e qytetarëve për t'i zbatuar dhe respektuar këto të drejta pranë shtëpisë, është e kotë të shpresojmë për përparim në botën më të madhe.

Diskutoni me nxënësit këtë fragment:

- Çfarë mendoni se do të thotë Eleanor Roosevelt me "të drejta universale"?
- Disa njerëz mendojnë se vlerat universale ose standardet e sjelljes janë të pamundura. Çfarë mendoni ju?
- Pse mendoni se OKB zgjodhi fjalën universale në vend të fjalës ndërkombëtare?

Hapi i katërt

Jepuni nxënësve nga një kopje të Shtojcës 1, duke iu shpjeguar se ky dokument ka për qëllim t'u ofrojë të gjithë njerëzve drejtësi, mundësi dhe dinjitet të barabartë.

Diskutoni “A janë të drejtat e njeriut domosdoshmërisht të drejta ligjore?”.

Ftojini të diskutojnë rreth pyetjes "Çfarë do të thotë të jesh gjallë? Kur fillon jeta? Kur përfundon jeta? A është e drejta për të jetuar një e drejtë njerëzore? Kur fillojnë dhe mbarojnë të drejtat e njeriut?”.

Hapi i pestë

Ndajini nxënësit në grupe pune dhe jepuni si detyrë të vizatojnë një pemë në një letër të madhe A3.

Shkruani në pemë (*tek gjethet, frutat, lulet ose degët*) ato të drejta të njeriut që ata mendojnë se të gjithë njerëzit i kanë të nevojshme për të jetuar me dinjitet.

Një pemë ka nevojë për rrënjë që të rritet dhe të lulëzojë. Vendosini të vizatojnë rrënjët e pemës (rreth 3) dhe të shkruajnë mbi to ato gjëra që shërbejnë si themele për lulëzimin e të drejtave të njeriut. Për shembull, një ekonomi e shëndetshme, funksionimi i drejtësisë, cilësi e mirë arsimimi etj.

Kur vizatimet të jenë të plota, kërkoni që secili grup të paraqesë pemën e tij dhe të shpjegojë arsyetimin që ka përdorur në përzgjedhjen e të drejtave/rrënjëve.

Hapi i gjashtë

Punë me Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut

- Përputhni frutat, gjethet dhe degët me nenet e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (*Shtojca 1*) dhe shkruani numrin e nenit pranë secilës fjalë.
- Prezantoni këto punime në klasë ose në ambientet e tjera të shkollës.
- Diskutoni me nxënësit rreth shqetësimeve që ata kanë me respektimin e të drejtave të njeriut në ambientet e klasës, shkollës apo në ambientet jashtë shkollës.

Hapi i shtatë

Veprimtari për tolerancën

Bashkëbisedim

- Ndani nxënësit në dy grupe. Grupi i parë liston tiparet e njerëzve tolerantë, ndërsa grupi tjetër liston tiparet e njerëzve jo tolerantë.
- Çfarë anësh pozitive ka të qenit tolerant?
- A ka shfaqje të mungesës së tolerancës në shkollë dhe në klasë?
- Çfarë duhet të bëni, kur nuk bini dakord me njëri- tjetrin?
- Çfarë rrugësh duhen ndjekur për të edukuar tolerancën?
- A mund të organizojmë një veprimtari për shkollën që synon të zhvillojë tolerancën?

Hapi i tetë

Në përfundim të dy orëve, mësuesi bën konkluzionet dhe falënderon nxënësit për punën dhe kontributin e tyre.

II. SIGURIA NË SHKOLLË

Të gjithë aktorët që merren me punën me fëmijët duhet të kuptojnë se fëmijët kanë nevojë për krijimin e një mjedisi mbrojtës dhe mbështetës, gjithashtu. Edhe në ato raste kur ky mjedis ndihet i kërcënuar janë këta aktorë që duhet të minimizojnë dhe reduktojnë deri në zbardhje të faktorëve që kanë çuar në krijimin e kësaj klime në mjedisin e tyre. Fëmijët kanë shumë nevojë të rriten të shëndetshëm dhe të arsimuar dhe duhen respektuar nevojat e tyre në të gjitha sistemet me të cilat fëmija ndërvepron.

Një pjesë mjaft të konsiderueshme të kohës, fëmijët e kalojnë në mjedisin e shkollës. Ndaj mbetet e një rëndësie të veçantë që të jemi në koherencë me vlerësimin e rrezikut që fëmijët mund të përballen si në mjedisin e shkollës ashtu edhe në komunitet. Sjelljet anti sociale, fenomeni i bullizmit etj., janë disa nga fenomenet sociale që po prekin zhvillimin e fëmijëve çdo ditë brenda sistemit arsimor, por jo vetëm. Edhe në ato raste kur nuk arrijnë të ofrojnë zgjidhje apo të pamundësisë për të matur shkallën e rrezikut të fëmijëve, është shumë e rëndësishme që këto fenomene si sjelljet anti sociale si bullizmi apo forma të tjera të dhunës, të adresohen në mekanizmat institucionalë që janë kompetentë. Ne e kemi për detyrë të bëjmë të mundur të mbështesim fëmijët tanë në mjedisin e shkollës duke pasur në fokus krijimin e një mjedisi mbështetës dhe gjithëpërfshirës për çdo fëmijë. Kjo bëhet e mundur vetëm kur marrim në konsideratë koordinimin me prindërit dhe komunitetin nga vjen nxënësi.

Përkufizimi i shkollave të sigurta

Koncepti i shkollave të sigurta sot është bërë global. Ai mbështetet në filozofinë e krijimit të mjediseve të shëndetshme, të sigurta dhe miqësore për fëmijët e moshës shkollore.

Vende të ndryshme kanë hartuar dhe kanë përpunuar dokumentacionin që synon garantimin e kushteve të sigurisë së lartë në shkollë. Në dokumentacionin që lidhet me sigurinë në shkolla përfshihet:

- Legjislacioni për sigurinë e shkollave që parashikon mjediset e ngritjes së shkollave, standardet e ndërtimit, kushtet e sigurisë në klasa dhe laboratorë, mbrojtjen kundër zjarrit dhe tërmeteve, pajisjen me mjetet e nevojshme që rrisin shkallën e sigurisë për të gjithë fëmijët si shkallë të lëvizshme, këndin e mbrojtjes kundra zjarrit etj.
- Informimi për shkallën e sigurisë në shkolla realizohet nga njësitë arsimore vendore, të cilat duhet të mbledhin një informacion të saktë për gjendjen e sigurisë në të gjitha shkollat që mbulojnë. Ato duhet të informohen herë pas here për problematikat që shfaq

struktura ndërtimore e shkollës, tavani, shkallët, kushtet higjieno - sanitare etj., duke shmangur në këtë mënyrë pasojat e rrezikshme për çdo nxënës.

- Rregulloret që ndihmojnë në rritjen e sigurisë së nxënësve brenda mjediseve shkollore dhe krijimin e atmosferës së shëndetshme. Çdo shkollë harton rregulloren e vet që garanton jetë cilësore dhe të shëndetshme për nxënësit, mbrojtje kundra dhunës, aksidenteve, sëmundjeve infektive në mjediset shkollore dhe sheshet e lojërave etj. Mbështetur në rregulloret përkatëse shkollave u kërkohet të pajisin mjediset e ndryshme me mjetet e nevojshme të mbrojtjes, p.sh bombolën kundër zjarrit, kutinë e ndihmës së shpejtë etj.
- Udhëheqje dhe standarde sigurie. Shkolla u ofron stafëve pedagogjike dhe jo vetëm atyre, nxënësve dhe prindërve udhëzime rreth rreziqeve të ndryshme me të cilat fëmijët mund të ballafaqohen në komunitet duke filluar që nga rregullat e qarkullimit rrugor dhe duke vazhduar me pajisjet dhe substancat laboratorike të sigurta, me rastet e emergjencave, të sjelljes me të panjohurit. Në këtë kontekst parashikohen gjithashtu njohuritë dhe aftësitë me të cilat duhet të pajisen nxënësit në drejtim të kapërcimit të situatave që lidhen me aksidentet e ndryshme.

Praktika pune të pasura

- ✓ *Ngritje kapacitetesh:* Në nivele vendore, por edhe qendrore është e domosdoshme të organizohen seminare dhe takime me mësues dhe drejtues për standardet e sigurisë në shkolla duke evidentuar gjithashtu dhe praktikatat më të mira të punës në këtë drejtim.
- ✓ *Praktikime të provës së sigurisë:* Shkollat duhet të organizojnë të paktën një herë në vit përmes alarmit fals situata emergjence në të cilat u kërkohet si mësuesve ashtu dhe nxënësve kapërcimi i tyre. Nxënësit duhet të praktikohen të ruajnë gjakftohtësinë, kalimin në korridore dhe daljen jashtë shkollës, pa krijuar kaos dhe panik. Ushtrime të tilla zhvillohen në shumicën e shkollave të vendeve të ndryshme të botës dhe synojnë të aftësojnë nxënësit për përballimin e situatave të pazakonshme sikurse janë fenomenet natyrore (tërmete, përmbytje, etj.) dhe të tjera si zjarri, përdorimi i armëve, hyrja e të panjohurve në mjediset e shkollës për qëllime terrorizmi, dhune, grabitjeje etj.
- ✓ *Vlerësimi i sistemit të sigurimit:* Shkollat duhet të zhvillojnë vlerësime të herëpashershme të sistemit të sigurisë së shkollës. Ato duhet t'i përgjigjen pyetjeve të tilla: Në rast se bie zjarr, cilat mund të jenë rrugët e kalimit të nxënësve dhe mësuesve për të dalë jashtë ndërtesës? Në rast përmbytjeje, cili është vendi më i mirë për të akomoduar fëmijët pa rrezik të lartë. Ngritja e një grupi pune për vlerësimin e gjendjes së sigurisë në shkollë

është një praktikë e re që duhet të zërë vendin e duhur në punën e përditshme të drejtorit të shkollës

- ✓ *Kontroll të përhershëm për situatën reale:* Tanimë ne kemi në duart tona dokumentacionin e nevojshëm të sigurisë së shkollave, legjislacionin e duhur që kërkon zbatimin e masave të sigurisë në shkollë, rregulloren tonë të brendshme mbi këtë çështje; zhvillimin e seminareve dhe takime me stafin pedagogjik për të rritur kapacitetin e tyre, për të menaxhuar situata apo fenomene që çënojnë mirëqenien e sistemit arsimor.

ORGANIZIMI I ORËVE PËR TEMËN “SIGURIA NË SHKOLLË”

Rezultatet e pritshme nga trajtimi i kësaj teme.

Nxënësi:

- Informohet për shkallën e sigurisë në shkollën ku ndjek mësimet;
- Është i vetëdijshëm për kujdesin që duhet të tregojë gjatë qëndrimit dhe lëvizjes në mjediset e shkollës;
- Njeh dhe zbaton rregulloren e brendshme të shkollës, sidomos nenet e saj që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë;
- Bëhet i aftë për të vetëvepruar në raste emergjencash në shkollë;
- Përfshihet në grupe pune për vlerësimin e gjendjes së sigurisë në shkollë;
- Praktikohet si të ruajë gjakftohtësinë, lëvizjen në korridore dhe daljen jashtë shkollës, pa krijuar kaos dhe panik;
- Aftësohet nxënësi për përballimin e situatave të pazakonshme sikurse janë fenomenet natyrore (tërmete, përmytje, zjarri etj.) dhe të tjera si, përdorimi i armëve, hyrja e të panjohurve në mjediset e shkollës për qëllime terrorizmi, dhune, grabitjeje etj.
- Interesohet për përmirësimin e kushteve të sigurisë në shkollë;
- Shpreh dëshirën për të marrë veprime të përgjegjshme.

Metodat dhe teknikat mësimore: stuhi mendimi, kllaster, lojë me role, bashkëbisedim, ese.

Koha mësimore: 2 orë mësimi (45 minuta + 45 minuta).

Hapi i parë

Mësuesi organizon një stuhi mendimi për sigurinë në shkollë. Nxënësit shprehin çfarë kanë lexuar ose kanë dëgjuar rreth sigurisë në shkollë. Më specifikisht, atyre u kërkohet të shprehen se si i vlerësojnë kushtet e sigurisë në shkollë. Më pas mësuesi paraqet para nxënësve një listë pyetjesh që lidhen me standardet e sigurisë në shkollë.

Listë pyetjesh për kushtet e sigurisë në shkollë

1. A janë të pranishme patrullat e policisë së shtetit në oraret e lëvizjes së nxënësve në shkollë (në mëngjes, gjatë pushimit dhe në dalje) për rritjen e sigurisë në shkollë?
2. A ka shërbim të ruajtjes fizike të shkollës?
3. A ka shkolla roje civile apo oficer sigurie?
4. Si garantohet siguria në shkollë, nëse nuk ka roje?
5. A është e rrethuar shkolla?
6. Si realizohet ndriçimi i shkollës?
7. Si sigurohet furnizimi me ujë (dhe me ujë të pijshëm) i shkollës?
8. A ofron ndihmën e shpejtë shkolla?
9. Sa i sigurt është interneti në shkollë?
10. A ka shkolla sistem zanor alarmi?
11. A ka shkolla sistem vëzhgimi (kamera)?
12. Si është dhe si realizohet komunikimi me policinë?

Nxënësit vihen në punë për të klikuar listën e mësipërme. Më tej, diskutohet për rastet kur nxënësit nuk kanë përgjigje, sepse mund të jenë të painformuar. Nëse nxënësit e tjerë apo mësuesi kanë informacionin e mjaftueshëm, ky informacion u paraqitet të gjithë nxënësve të klasës.

Nëse është e nevojshme, klasa ndan detyrat për të plotësuar e pasuruar informacionin.

Hapi i dytë

Bashkëbisedim: Probleme të tjera që lidhen me sigurinë në shkollë.

Nxënësit lihen të shprehen lirshëm për probleme të tjera që lidhen me sigurinë në shkollë, të tilla si: situatat e pazakonshme sikurse janë fenomenet natyrore (tërmete, përmytje, etj.) dhe të tjera si zjarri, përdorimi i armëve, hyrja e të panjohurve në mjediset e shkollës për qëllime terrorizmi, dhune, grabitjeje etj.

Hapi i tretë

Ese: Sa i /e sigurt jam në shkollën time.

Nxënësve u lihet koha e mjaftueshme për të shkruar esenë.

Hapi i katërt

Bashkëbisedim:

Mësuesi do të orientojë bashkëbisedimin në dy aspekte:

1. Shkalla e sigurisë në shkollën tonë.
2. Sfidat për përmirësimin e sigurisë në shkollën tonë.

Ora e mësimit mund të mbyllet me hartimin e një liste nevojash të nxënësve për përmirësimin e sigurisë në shkollë dhe me përpilimin e shkresës drejtuar drejtorisë së shkollës dhe bashkisë me kërkesat bashkëlidhur shkresës.

Hapi i pestë

Si të ruajmë gjakftohtësinë, lëvizjen në korridore dhe daljen jashtë shkollës, pa krijuar kaos dhe panik?

Njohja me tematikën e orës:

Mësuesi njih nxënësit me synimin që ka ora: aftësimi praktik i nxënësve për të ruajtur gjakftohtësinë, lëvizjen në korridore dhe daljen jashtë shkollës, pa krijuar kaos dhe panik.

(Paraprakisht, mësuesi ka koordinuar punën e drejtuesit të shkollës për të organizuar një alarm të rremë, p.sh., “rënie zjarri”, “peng marrje” etj., me të gjithë personelin mësues-nxënës).

Hapi i gjashtë

Dhënie e alarmit të rremë. Mësuesi ushtron nxënësit si të ruajnë gjakftohtësinë, si të lëvizin nëpër korridore, si të shfrytëzojnë shkallët e emergjencës për të dalë jashtë shkollës, pa krijuar kaos dhe panik te vetja dhe tek të tjerët.

Hapi i shtatë

Përfundime nga ushtrimi praktik për veprimet në rast emergjence në shkollë.

III. BULLIZMI, SJELLJE ANTISOCIALE QË ÇON NË DHUNË

Çfarë është bullizmi?

Tashmë bullizmi nuk është më një fjalë e huaj. Të gjithë në një formë apo tjetrën kemi dëgjuar diçka mbi këtë fenomen, kaq prezent dhe shqetësues në shkollat tona. Po çfarë është bullizmi? Më poshtë janë dhënë disa përkufizime për bullizmin.

Bullizëm janë sjelljet e përsëritura, të dëmshme e agresive ndërmjet njerëzve që ndryshojnë në nivelin e tyre të forcës dhe mund të jetë si fizik, ashtu edhe psikologjik. Ato përfshijnë goditjet, rrahjet, ngacmimet verbale, gjestet fyese, përjashtimin ose thjesht presionin për t'iu përshtatur atyre që dëshiron apo thotë bullisti.

Bullizmi është një formë e sjelljes agresive e manifestuar nga përdorimi i forcës apo i detyrimit (shtrëngimit) për të ndikuar të tjerët. Ai mund të shfaqet si kanosje verbale, kërcënim fizik ose detyrim dhe është i drejtuar në mënyrë të përsëritur ndaj të njëjtës viktimë, duke u nisur ndoshta nga raca, gjinia, feja, aftësia etj.

“**Bullizmi** është një dëshirë për të dëmtuar tjetrin, një veprim që lëndon, një përdorim i padrejtë i forcës, një kënaqësi e dukshme e agresorit, si edhe një ndjenjë e përgjithshme e të qenit mbizotërues ndaj viktimës”. Ken Rigby

Në kontekstin e shkollës:

Bullizmi është sjellje e dhunshme e kryer nga një nxënës/ mësues apo një grup nxënësish kundrejt një nxënësi tjetër, pa ndonjë shkak të dukshëm dhe përfshin dhunë të përsëritur fizike, psikologjike apo dëmtime të natyrës sociale etj. Bullizmi ndodh kryesisht në shkollë apo në mjediset të tjera ku fëmijët qëndrojnë bashkë.

Një nxënës është viktimë e bullizmit, kur ai në mënyrë të përsëritur dhe për një kohë të gjatë, është ekspozuar ndaj veprimeve negative të një ose disa nxënësve.

Ata ndaj të cilëve ushtrohet bullizëm, quhen viktimat e bullizmit. Ata që shkaktojnë bullizëm quhen bullist.

Nga ndryshon bullizmi nga dhuna?

Bullizmi është një nën pjesë e ushtrimit të dhunës në shkollë. Dhunë në shkollë konsiderohet “çdo sjellje e cila synon të dëmtojë, fizikisht dhe emocionalisht, personat në shkollë, si dhe pronën e tyre vetjake”. Pra, dhuna në shkollë përfshin, por nuk është e kufizuar vetëm në sjellje të tilla si: viktimizimi i fëmijës dhe i mësuesit, dhunimi i kryer nga fëmija dhe/ose mësuesi, ngacmimi fizik dhe psikologjik, përleshjet, bullizmi, dëmtime fizike dhe psikologjike të mësuesit dhe të nxënësit, dhuna seksuale, përdorimi i armëve në mjediset e shkollës etj.

Cilat janë llojet e bullizmit?

Midis formave që merr kjo sjellje e padëshiruar, këto janë kryesoret:

Bullizmi verbal është ngacmimi, sharjet, kërcënimi, përhapja e thashethemeve dashakeqe, nofkat ofenduese etj. Qëllimi i tij kryesor është degradimi i viktimës. Bullizmi verbal haset përgjithësisht te vajzat, por nuk mungon edhe te djemtë.

Bullizmi social është dëmtimi i imazhit të nxënësit/ve, duke e lënë jashtë lojërave apo grupit, duke e shpërfillur apo duke mos e ftuar në festat e klasës apo të shkollës, duke prishur miqësinë etj.

Bullizmi fizik është bullizmi që merr formën e abuzimit fizik (p.sh., grushtimi, shkelmimi, goditje të formave të ndryshme, shtytje, vjedhje e sendeve personale, shkatërrim i librave etj.). Bullizmi fizik është tipik për meshkujt, por nuk përjashtohet as te femrat.

Bullizmi seksual është sjellje seksuale e padëshiruar fizike ose verbale, që përfshin pohime seksuale dashakeqe ose shënime seksualisht diskriminuese dhe kontakte të padëshirueshme fizike që bëhen nga dikush në një mjedis dhe që janë fyese dhe të pakëndshme për nxënësin dhe bëjnë që ai të ndjehet i turpëruar.

Bullizmi virtual/ kibernetikë nënkupton përdorim informacioni dhe komunikimi negativ të qëllimshëm nga një ose disa individë, përmes teknologjisë elektronike, e cila lejon përhapjen e kërcënimeve ose të ngacmimeve kundrejt një ose disa nxënësve, duke postuar tekste, foto, ose video të tyre etj.

Bullizmi racist është bullizmi që u drejtohet njerëzve të një race ose kulturë të veçantë.

Cilat janë tiparet e nxënësve që janë viktimat të bullizmit?

Viktimë e bullizmit quhet një nxënës që nuk ndjehet i sigurt në shkollë, për shkak të kërcënimeve ose të dëmtimeve fizike nga një ose disa nxënës që ndodhen në shkollën e tij. Viktima nuk ka shokë ose është një tip që preferon të qëndrojë vetëm. Gjithashtu, viktima mund të jetë një nxënës që:

- ka aftësi të veçanta;
- nuk mund të vetëmbrohet;
- ka vetëvlerësim të ulët;
- e konsideron veten dështak, të shëmtuar dhe të papëlqyeshëm nga të tjerët.

Viktimat e bullizmit ndahen në dy grupe: pasive dhe aktive.

Viktimat pasive :

- janë fizikisht më të dobët se shokët e klasës;
- shmangin zënkat fizike dhe qëndrojnë të veçuar;
- janë vazhdimisht në ankth;
- nuk kanë shokë;
- etj.

Mungesa e shokëve i bën lehtësisht shënjestra për bullistin. Viktima pasive është lloji më i zakonshëm i viktimës dhe më i identifikueshmi. Në këtë rast, viktima ka pak burime mbështetjeje dhe është objektiv i lehtë. Shpesh viktima përpiqet ta kënaqë agresorin në

mënyra të ndryshme dhe nuk lufton e për këtë arsye, këto lloje viktimash përjetojnë më shumë shenja vetmie dhe janë më të rrezikuar për të kryer vetëvrasje.

Viktimat provokuese karakterizohen nga hiperaktiviteti ose të qenët jashtëzakonisht shumë aktivë, nga ankthi dhe kanë forma sjelljesh që provokojnë ose i irritojnë nxënësit e tjerë të klasës. Kjo kategori përfshihet në dukurinë e bullizmit edhe si viktimë, edhe si agresorë. Ata karakterizohen si antagonistë dhe me probleme me përqendrimin, kanë mungesë të aftësive sociale për të kundërvepruar dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme situatave konfliktuale.

Cilat janë tiparet e bullistit?

Më poshtë janë renditur disa tipare të përgjithshme të një bullisti.

- Përpiqet që të ushtrojë kontroll ndaj moshatarëve të tij përmes sulmeve fizike dhe verbale.
- Shqetësohet për popullaritetin e tij në grup dhe i pëlqen të jetë udhëheqës apo drejtues grupi.
- Nuk ka vetëvlerësim të ulët dhe është popullor në shoqërinë e tij.
- Mund të ketë probleme të ndryshme në familje, përfshirje të ulët të prindërve në edukimin e tij apo mbarëvajtjen në shkollë etj.
- Mund të ketë vështirësi në ndjekjen e rregullave apo udhëzimeve apo ka shokë të cilët janë bullist.
- Ka qëndrime pozitive ndaj përdorimit të dhunës.
- Mund të përdorë drogë dhe alkool.
- Mund të ketë prindër të shkujdesur, si dhe mund të ketë pasur histori abuzimi
- Mund të jetë i inatosur, i frikësuar, i lënduar ose i frustruar.

Cilat janë pasojat e bullizmit?

Disa nga pasojat e bullizmit janë renditur më poshtë. Nxënësit:

- zhvillojnë një ndjesi frike dhe mungese respekti në shkollë;
- përjetojnë pengesa në procesin e mësim nxënies;
- ndjehen të pasigurt;
- nuk e pëlqejnë shkollën;
- fillojnë të perceptojnë mësuesit dhe personelin shkollor si jo të interesuar për atë që ndodh në jetën e tyre dhe të paafte për të pasur kontroll për situatën;
- largohen nga shkolla;
- kanë probleme psikologjike;
- kanë probleme fizike;

- kanë ndjesinë e përjashtimit;
- përjetojnë tension në marrëdhënie me të tjerët.

Si mund ta parandalojmë dhe ta luftojmë bullizmin në shkollë?

Parandalimi

Bullizmi do të vazhdojë të ekzistojë dhe viktimat do të vazhdojnë të vuajnë, nëse shkollat nuk kanë një strategji dhe nuk zhvillojnë politika bashkëkohore për të krijuar një mjedis edukativ të sigurt dhe mbështetës, ku të sigurohet që çdo nxënës të jetë i pranuar dhe i përfshirë. Parandalimi i bullizmit është më i rëndësishëm se trajtimi i tij. Për këtë shkolla duhet të ndërtojë dhe të zbatojë disa strategji. Më poshtë janë sugjeruar disa prej tyre.

- Trajnimi i personelit mësimor rreth karakteristikave apo profilit tipik të nxënësve që janë viktima dhe agresorë.
- Strategjia e rritjes së vetëvlerësimit të nxënësit dhe zhvillimi i aftësive të tyre sociale.
- Strategjia e ndërtimit dhe zhvillimit të aftësive për të zgjidhur konfliktet.
- Strategjia e krijimit të kulturës gjithëpërfshirëse, pavarësisht ndryshimeve etnike, gjinore, shoqërore, gjuhësore etj.
- Strategjia e ndërtimit dhe zhvillimit të aftësive për të zgjidhur problemet.
- Strategjia e ndërtimit dhe zhvillimit të aftësive empatike.
- Strategjia e informimit dhe ndërgjegjësimit seksual.

Si mund të trajtohen rastet e bullizmit?

Një ndër hapat fillestarë dhe nga më të rëndësishmit është që stafi i shkollës të ndërgjegjësohet që bullizmi është i papranueshëm dhe nuk duhet të tolerohet. Kjo sepse shumica e të rriturve e perceptojnë bullizmin si një pjesë e procesit të rritjes që fëmijët duhet ta zgjidhin vetë, pavarësisht se studime të shumta e kundërshtojnë këtë fakt. Heshtja nënkupton pranim dhe kur nuk flitet për bullizmin, kjo bën që individët të mos e kuptojnë qartë se kjo sjellje nuk lejohet në shkollë.

Pikë së pari, duhet të dimë se si t'ju flasim nxënësve për bullizmin, të sigurohemi që ata e kanë kuptuar çfarë do të thotë bullizëm dhe të kuptojnë se në asnjë moment nuk duhet ta pranojnë atë. Nëse duam të ndihmojmë nxënësit, atëherë duhet të përpiqemi të jemi edhe shokët e tyre, të tregojmë interes për jetën e tyre shkollë, aktivitetet e përditshme, shokët, ecurinë e çdo dite apo edhe shqetësimet e tyre.

Që të kuptosh nëse nxënësit janë ose jo pjesë e bullizmit (qoftë në pozicionit e bullistit apo të viktimës së bullizmit) mund të nisësh me disa pyetje. Mes tyre, disa më kryesoret janë:

- Çfarë do të thotë për ty bullizëm?
- Mund të më përshkruash se si janë fëmijët bullist? Pse mendon që ata janë bullist?
- Cilët janë të rriturit tek të cilët beson më shumë nëse duhet të flasësh për bullizmin?
- A je ndjerë ndonjëherë i trembur të shkosh në shkollë sepse kishe frikë mos bullizohesh? Si je përpjekur ta ndryshosh apo ta përmirësosh këtë gjë?
- Si mendon, çfarë mund të bëjnë prindërit që bullizmi të ndalojë?
- A je përjashtuar ndonjëherë me qëllim nga grupi fëmijë të tjerë, ti ose shok të tjerë? A mendon se ky është bullizëm? Pse po ose pse jo?
- Çfarë bën zakonisht nëse sheh një sjellje bulliste?
- A sheh ndonjëherë fëmijë në shkollën tënde që bëhen viktimë të bullizmit? Nëse po, si të bën kjo të ndihesh?
- A ke ndihmuar ndonjëherë dikë që ka qenë viktimë e bullizmit? Çfarë ndodhi? Çfarë do të bëje nëse do të ndodhte sërish?

Nga ky bashkëbisedim mësuesi merr një lloj informacioni nëse në klasë ka ose jo bullizëm. Zhvillimi i kësaj teme në disa orë të kujdestarisë u jep mundësinë nxënësve të ndërhyjnë për pasojat e bullizmit.

Kur shfaqet një ngjarje bulliste rekomandohet që viktimë të vendoset në një dhomë më vete pa praninë e agresorit/agresorëve në mënyrë që ai ta tregojë historinë pa u ndikuar prej tyre. Nëse historia e nxënësit është shumë serioze, duhet të mbahet një takim në shkollë me mësuesit, me nxënësit e përfshirë, si dhe me prindërit e tyre, në mënyrë që problemi të zgjidhet menjëherë e pa pasur pasoja edhe më të rënda.

Këshilla për mësuesit

- Bëni disa pyetësorë për të identifikuar vendin dhe kohën kur ndodh kryesisht bullizmi.
- Njoftoni menjëherë kolegët, psikologun e shkollës dhe prindërit e fëmijës nëse mendoni se një nxënës është bullist ose viktimë.
- Ndaloni bullizmin menjëherë. Hartoni menjëherë një plan pune për ta luftuar atë.
- Jini më të pranishëm dhe vigjilentë në koridore, në shkallë, në klasa gjatë pushimeve, sepse pjesa më e madhe e shfaqjeve të bullizmit ndodhin kur nuk ka mbikëqyrje nga stafi i shkollës.
- Trajtoni të gjithë nxënësit me respekt dhe dashuri, pasi kështu shërbeni si një model i mirë sjellje për fëmijët.
- Organizoni aktivitete në klasë për bullizmin (ndihmoni klasën tuaj që ta identifikojë bullizmin në libra, seriale televizive, filma dhe diskutoni për pasojat dhe zgjidhjen e problemit).

- Bashkëbisedoni me nxënësit në lidhje me problematikat e bullizmit (këto biseda mund të bëhen edhe vetëm me një nxënës, nëse shihni që ai ka probleme me bullizmin).
- Bashkëbisedoni për bullizmin me kolegët tuaj. Si një grup do të jeni më të aftë për të monitoruar ambientet e shkollës. Diskutoni rreth bullizmit në përgjithësi, dhe për raste të veçanta me nxënësit.
- Ndëshkoni sjelljen e bullistit (p.sh., mos e lejo të marrë pjesë në ndonjë aktivitet).
- Sqaroni nxënësit rreth sjelljeve të pranueshme dhe të papranueshme në klasë dhe në shkollë.
- Mos bëni dhe mos thoni asgjë që nxënësit ta interpretojnë si favorizim të një nxënësi të caktuar.
- Mos u konfrontoni me asnjë nxënës problematik në mjediset e klasës.

Puna si mësues kujdestar me prindërit

Një aspekt i rëndësishëm për të parandaluar dhe për të luftuar bullizmin është puna me prindërit. Një bashkëpunim sa më i mirë mes familjes dhe shkollës do të ishte fillim i mirë për të eliminuar këto sjellje, të cilat asnjë prind nuk do të donte t'i gjente te fëmija i tij.

Në një nga mbledhjet me prindër, mësuesit kujdestarë mund t'i informojnë ata për bullizmin, llojet e tij dhe eliminimin e tij. Gjithashtu, në faqen e shkollës mund të jepen këshilla për prindërit në lidhje me bullizmin. Më poshtë janë dhënë dy lloje këshillash për prindërit.

a) Këshilla për prindërit

Si ta dalloni që fëmija juaj është viktimë e bullizmit?

- ⇒ Humb ose shkatërron gjërat personale (veshje, celular, çanta etj.).
- ⇒ Nuk shoqërohet me shokët e dikurshëm dhe nuk ka më jetë sociale.
- ⇒ Ka rezultate të dobëta në shkollë.
- ⇒ Nuk ka dëshirë përtë shkuar në shkollë.
- ⇒ Ka dhimbje koke, dhimbje barku apo ankesa të tjera fizike.
- ⇒ Shpenzon më shumë kohë me celularin dhe në internet.
- ⇒ Ka vetëvlerësim të ulët.
- ⇒ Largohet pa arsye nga shtëpia.
- ⇒ Ka sjellje vetëshkatërruese.
- ⇒ Nuk ka oreks.
- ⇒ Ka probleme me gjumin.

Këshilla për prindërit

- Flisni çdo ditë me fëmijën tuaj. Dëgjojeni me vëmendje dhe interes atë.
- Bëjini pyetje se si e ka kaluar ditën në shkollë (përfshirë edhe ngjarjet që kanë ndodhur gjatë rrugës për në shkollë ose gjatë pushimeve mes orëve). Pyeteni edhe për nxënësit e tjerë të klasës dhe të shkollës.
- Shpenzoni kohë në shkollë (vullnetarë, merrni pjesë në aktivitetet e shkollës etj.).
- Jeni një shembull i mirë për fëmijën tuaj.
- Flitni me fëmijën tuaj rreth bullizmit.
- Komunikoni me mësuesit nëse konstatooni që fëmija shfaq tipare të bullizmit.

ORGANIZIMI I ORËVE PËR TEMËN “BULLIZMI, SJELLJA ANTISOCIALE QË ÇON NË DHUNË”

Rezultatet e pritshme nga trajtimi i kësaj teme.

Nxënësi:


- përcakton se çfarë është bullizmi dhe se cilat janë karakteristikat kryesore të tij;
- përshkruan llojet kryesore të bullizmit;
- analizon shkaqet kryesore të bullizmit;
- përshkruan profilin e viktimës dhe të agresorit që ushtron dhunë mbi viktimën;
- gjykon për pasojat që shkakton bullizmi;
- ndërmer nisma për parandalimin e bullizmit;
- gjykon për vlerën e miqësisë dhe të sjelljes korrekte në shoqëri.

Metodat dhe teknikat mësimore: stuhi mendimi, kllaster, lojë me role, bashkëbisedim

Koha mësimore: 2 orë mësimi (45 minuta+45 minuta)

Hapi i parë

Mësuesi organizon një stuhi mendimi për bullizmin. Nxënësit shprehin çfarë kanë lexuar ose kanë dëgjuar rreth bullizmit. Më pas mësuesi plotëson në tabelë një kllaster për karakteristikat e bullizmit.



Hapi i dytë

Zhvillohet me nxënësit një quiz. Qëllimi i tij është që nxënësit të kuptojnë që bullizmi është një fenomen shumë i përhapur. Mësuesi lexon pyetjet dhe nxënësit japin përgjigjet e tyre. Përndonjë nga pyetjet, mësuesi mund të kërkojë përgjigje të argumentuar.

Quiz për bullizmin

1. Sa përqind e njerëzve nën moshën 25 vjeç janë viktime të bullizmit?
 - a) 15%;
 - b) 20%;
 - c) 45%;
 - d) 54%.**

2. Njerëzit që kanë qenë viktime të bullizmit, ka gjasa të ushtrojnë bullizëm mbi të tjerët.
 - a) E vërtetë**
 - b) E gabuar


3. Njerëzit me nevoja të veçanta janë më shumë viktime të bullizmit se sa njerëzit që nuk i kanë këto nevoja.
 - a) E vërtetë**
 - b) E gabuar

4. Djemtë ushtrojnë më shumë bullizëm se vajzat.
 - a) E vërtetë**
 - b) E gabuar

5. Cili është arsyeja kryesore që njerëzit përjetojnë bullizmin?
 - a) Për pamjen e jashtme.**
 - b) Për notat e mira.
 - c) Për interesat dhe pasionet.
 - d) Për seksualitetin.

6. Sa për qind e njerëzve pranojnë se bëjnë diçka abuzive ndaj një personi tjetër në internet?
 - a) 12%
 - b) 32%
 - c) 69%**
 - d) 79%

7. Në cilën platformë online ka më shumë bullizëm?



8. Çfarë duhet të bëni nëse ju ngacmojnë online”
- U bëni report personave.
 - U thoni që të mos lënë komente abuzive në faqen tuaj.
 - U shkruani një mesazh privat që të sqaroheni.
 - I injoroni ata.
9. Ku ndikon bullizmi?
- Në jetën shoqërore.
 - Në rezultatet mësimore
 - Në ambiciet për të ardhmen
 - Në vetëvlerësim.

Hapi i tretë

Diskutime rreth fotove


Në këtë fazë të orës së mësimit, nxënësit jo vetëm njihen me llojet e bullizmit, por edhe të bëhen empatikë dhe të kuptojnë pasojat e bullizmit.

Llojet e bullizmit. Mësuesi paraqet disa foto dhe fton nxënësit që të diskutojnë rreth tyre.

Foto e parë tregon një rast të *bullizmit verbal*.

Mësuesi u drejton pyetje nxënësve:

- Çfarë po ndodh mes djemve në foto?
- Si mendoni se ndihet djali, të cilin po e shajnë? Çfarë ndjesish po përjeton ai?



Bullizmi fizik

Mësuesi u drejton pyetje nxënësve:

- Çfarë ndjeni kur shihni një foto të tillë? A do donit të ishte vëllai ose një i afërm i juaji në një situatë të tillë?
- Bullizmi fizik ndodh vetëm mes djemve apo mes vajzave? Apo në të dyja rastet?

- Cilat janë pasojat e kësaj sjelljeje të djali i fotos? Po të djali që ushtron dhunë?




Bullizmi social

Mësuesi u drejton pyetje nxënësve:

- Çfarë ndjeni kur shihni një foto të tillë?
- Për çfarë bëhet viktimë e bullizmit social një nxënës? Thoni disa arsye.
- Si mendoni se ndihet vajza?



Bullizmi virtual



Mësuesi u drejton pyetje nxënësve:

- Çfarë po ndodh me vajzën? Çfarë shpreh fytyra e saj?
- Pse sillen kështu dy vajzat e tjera? Cilat mund të jenë arsyet?
- Si mund të zgjidhet ky rast.

Bullizmi racist



Mësuesi u drejton pyetje nxënësve:

- Për ç'loj bullizmi bëhet fjalë në këtë foto?
- A ka raste të bullizmit racist në vendin tonë?
- Do të donit të ishit në vendin e vajzës në foto?
- Çfarë problemesh krijon

Hapi i tretë

Lojë me role

Ky aktivitet lidhet me diskutimet rreth fotove. Loja me role ka për qëllim që nxënësit të evidentojnë arsyet që i çojnë njerëzit ushtrojnë bullizëm te të tjerët. Mësuesi ndan nxënësit në grupe (një grup për çdo lloj bullizmi) dhe kërkon nga çdo grup të luajë një skenar të shkurtër bullizmi dhe më pas fton pjesën tjetër të klasës për të dhënë komente dhe këshilla rreth situatës. P.sh.:

Shembull 1 (bullizmi virtual): Nxënësi A poston një foto abuzive për nxënësin B. Nxënësi C e sheh foton, por nuk di se çfarë të bëjë? Problemi vazhdon edhe në shkollë, pasi nxënësi A nxit nxënësin C të thotë gjëra të këqija për nxënësin B.

Shembull 2 (bullizëm verbal). Nxënësi A po kalon një periudhë të vështirë në shtëpi.

Prindërit e tij janë në prag të divorci dhe qeni i tij nuk është më. Ai ndihet i zemëruar dhe nuk ka me kë të bisedojë. Ai ia nxjerr inatin nxënësit B dhe sjellja e tij është vërtet problematike. Nxënësi C që është shok i nxënësit A, ka dijeni për problemet që po kalon ai. Çfarë mund të bëjë ai dhe shokët e tjerë të klasës për t'i ndihmuar.

Hapi i katërt

Shkaqet e bullizmit

Mësuesi ndan nxënësit në dy grupe.

Grupi i parë duhet të përcaktojë shkaqet pse një person mund të bie pre e bullizmit.

Grupi i dytë duhet të përcaktojë shkaqet pse një person ushtron bullizëm mbi të tjerët.

Nxënësit prezantojnë idetë e tyre. Mësuesi qartëson, plotëson dhe vlerëson mendimet dhe idetë e nxënësve.

Hapi i pestë

Krijimi i një posteri me jo më pak se 140 shkronja

Ky aktivitet do t'i ndihmojë nxënësit të kuptojnë më mirë bullizmin, si dhe do të frymëzojë ata që ta luftojnë atë. Mësuesi i ndan nxënësit ose në çifte ose në grupe dhe u kërkon që të hartojnë një poster për shkollën që synon të luftojë bullizmin.

Pjesa interesante e kësaj veprimtarie është që posteri nuk duhet të ketë më shumë se 140 karaktere (shkronja, shenja pikësimi etj.), kështu që ata duhet t'i përzgjedhin me kujdes dhe mençuri fjalët. Posterat më të bukur do të afishohen në ambientet e klasës dhe të shkollës.

Hapi i gjashtë

Krijimi i një liste me 10 këshilla

Mësuesi ndan nxënësit në grupe të vogla dhe i kërkon çdo grupi që të hartojë 10 këshilla që mund të ndjekin për të shpëtuar nga një situatë bullizmi. Më pas nxënësit i ndajnë këshillat

me pjesën tjetër të klasës. Mësuesi do të shohë se ka shumë përsëritje dhe mbivendosje, kështu që së bashku me nxënësit do të bien dakord për 10 këshillat e përdorura më shumë. Këto 10 këshilla afishohen në klasë.

Hapi i shtatë

Në përfundim të dy orëve, mësuesi bën konkluzionet dhe falënderon nxënësit për punën dhe kontributin e tyre.

IV. EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE RADIKALIZMI

Ekstremizmi i dhunshëm e radikalizmi, në të gjitha format e shfaqjet, përbëjnë, aktualisht, kërcënimet më serioze për paqen dhe sigurinë në mbarë botën. Kësisoj, lufta kundër këtyre kërcënimeve, pavarësisht se ku ndodhin apo nga kush vijnë, kërkon që aktorët qeveritarë të forcojnë bashkëpunimin në nivel kombëtar, si dhe atë rajonal e global.

- “**Ekstremizëm i dhunshëm**”¹, përdorimi i dhunës për arritjen e objektivave.
- “**Radikalizmi në dhunë**”², një vendim për të anashkaluar proceset politike apo metodat jo të dhunshme të nxitjes së ndryshimit, duke favorizuar përdorimin e metodave të dhunshme për të sjellë ndryshimin.
- “Kundëradikalizmi”, një paketë programesh sociale, politike, ligjore, arsimore dhe ekonomike të hartuara posaçërisht për t’i frenuar individët e pakënaqur (dhe, me gjasë, tashmë të radikalizuar) që t’i drejtohen terrorizmit.
- “Qëndresë”, faktorët, idetë, institucionet, çështjet, prirjet ose vlerat që iu japin mundësi individëve dhe komuniteteve t’i bëjnë qëndresë dhunës ose ta parandalojnë atë.
- Fjala “**ekstremist**” përkufizohet si “një person i cili ka pikëpamje ekstreme politike ose fetare, veçanërisht dikush i cili mbështet veprime të paligjshme, të dhunshme apo ekstreme”.
- Ndërsa një kuptim i fjalës “**radikal**” është “përfaqësimi apo mbështetja e një seksioni ekstrem të një partie”. Fjala “radikalizim” nënkupton lëvizjen brenda kësaj hapësire.

“Radikalizmi” i dhunshëm, konsiston në veprime aktive apo pranimin e dhunës si mjet për arritjen e objektivave të caktuara. Ndërsa në një kuptim më të gjerë të radikalizmit, vëmendja shtrihet mbi të gjitha veprimet aktive apo pranimin e ndryshimeve madhore në shoqëri, të

¹ Strategjia kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm 2014 - 2020

² Strategjia kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm 2014 - 2020

cilat mund të përbëjnë ose jo një rrezik për demokracinë dhe mund të përfshijnë ose jo rrezikun apo përdorimin e dhunës për arritjen e objektivave

Termi “*ekstremist*” mund të përdoret edhe për mënyrat e përdorura për arritjen e qëllimeve politike, të cilat karakterizohen nga mungesa e respektit për jetën, lirinë dhe të drejtat e tjetrit”.

Për të theksuar pasojën e dhunshme nga radikalizmi dhe në mënyrë që të bëhet dallimi nga forma jo të dhunshme të menduarit radikal disa studiues preferojnë të përdorin togfjalëshin “radikalizim i dhunshëm”.

Modele të ndryshme lidhur me shkaqet e ekstremizmit

- Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm nuk ndodhin brenda një dite. Në të shkuarën, studimet rreth terrorizmit përgjithësisht fokusoheshin mbi individin dhe përpiqeshin të jepnin shpjegime klinike mbi aktet terroriste të mbështetura në supozimin se ata reflektonin një farë çrregullimi mendor apo të personalitetit të personit.
- Sipas këtyre modeleve, radikalizmi shihet si një “*rrugëtim*” apo “*transformimi psikologjik*” i një individi apo grupi personash dhe jo si produkt i një vendimi të vetëm të marrë në një moment të caktuar. Borum, Randy (2011)

“Rrugëtimi” psikologjik i zhvillimit të ideologjive që justifikojnë ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin

- Në fazën e parë, personi gjykon situatën e tij si të padëshirueshme.
- Më pas, personi fillon të krahasojë situatën në të cilën ai ndodhet me kushtet më të favorshme të personave/grupeve të tjera dhe e konsideron këtë pabarazi si të padrejtë dhe të paligjshme.
- Disa persona do të fajësojnë një grup tjetër personash për kushtet e paligjshme të grupit të tyre. Ky grup personash ka mbërritur kështu në fazën e tretë e cila konsiston në fajësimin e një grupi tjetër dhe zhveshjen e këtij grupi nga vlerat njerëzore.
- Në fazën e fundit, ndaj grupit të personave të fajësuar fillojnë dhe krijohen stereotipe negative që përfshijnë të gjithë anëtarët e grupit. Në këtë fazë, dhuna konsiderohet legjitime pasi drejtohet ndaj një grupi të keq, i cili është përgjegjës për të gjitha padrejtësitë e perceptuara.

Nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm

Nxitës social ekonomikë:

- Perceptimet e përjashtimit dhe marginalizimit social
- Rrjetet shoqërore dhe dinamikat e grupit
- Pritshmëri të dështuara dhe privim relativ
- Nevoja të papërbushura sociale dhe ekonomike
- Lakmia apo shtimi i veprimtarive të paligjshme ekonomike

Perceptim i përjashtimit shoqëror dhe marginalizimi

Sipas Komisionit Evropian “përjashtimi social është procesi ku disa individë pengohen të marrin pjesë në mënyrë aktive në shoqëri si rezultat i varfërisë apo diskriminimit të tyre.”

Ky perceptim mund të jetë i përhapur veçanërisht ndërmjet të rinjve në zona periferike dhe të pazhvilluara dhe në mjedise ku strukturat familjare janë gërryer, mekanizmat shoqërorë nuk kontrollojnë më sjelljen e individëve dhe të rinjtë kalojnë shumë kohë larg aktiviteteve të dobishme.

Kuadri ligjor dhe institucional në Shqipëri

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar konventat dhe protokollet e Kombeve të Bashkuara mbi terrorizmin.

- Ajo është bashkësponsorizuese e Rezolutës 2178 (2014) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, si edhe Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit.
- Strategjia Kombëtare e Sigurisë e rishikuar në qershor të vitit 2014
- Në vitin 2015 në Tiranë, Shqipëri u mbajt Samiti Rajonal Ballkanik kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.
- VKM nr. 930 18.11.2015 “Për miratimin e strategjisë kombëtare 2014 – 2020 dhe planin e veprimit kundër ekstremizmit të dhunshëm”. Në zbatim të kësaj strategjie në vitin 2017 u krijua Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

Qëllimi i strategjisë kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm³

- Parandalimi për përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm, nëpërmjet përpjekjeve të lokalizuara, përfshi fuqizimin e mëtejshëm të të rinjve, familjes, grave dhe pakicave. Kanalizim i përpjekjeve drejt rrjeteve fetare, kulturore dhe arsimore.
- Përfshirje të shoqërisë civile, si e tërë, në miratimin e një qasjeje të përshtatur dhe proaktive për trajtimin e kësaj dukurie.

³ Strategjia kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm 2014 - 2020

- Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm synon të ruajë vlerat e tolerancës dhe harmonisë fetare, të mbrojtë të drejtat e njeriut, shtetin e së drejtës dhe demokracinë, si dhe të mbrojtë shoqërinë shqiptare nga ekstremizmi i dhunshëm.
- Nxitja e një mjedisi të sigurt, bazuar në respektimin e të drejtave dhe vlerave themelore.

Fushat për zhvillimin e kapaciteteve, politikave dhe mekanizmave për t'u përballur me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin⁴

- Shtrirja në komunitet dhe angazhimi i tij;
- Kundërvënja ndaj propagandës ekstremiste, duke përkrahur vlerat demokratike;
- Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse afatgjata të KEDH-së.

Strategjitë e parandalimit dhe të adresimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe të radikalizmit

- Komunikimi i drejtpërdrejtë
- Negocimi
- Media e shkruar dhe elektronike
- Gjykata

Komunikimi

Është procesi i marrjes dhe dhënies së mesazheve midis dy ose më shumë personave apo grupeve të caktuara sociale, është më tepër se fjalë, se shkëmbim informacioni, është xhest, veprim, tingull, është transmetim ndjenjash, sjelljesh, mendimesh, perceptimesh. Komunikimi njerëzor është jo vetëm proces por edhe akt. Si proces dinamik karakterizohet nga *Forca, Intesiteti, Ritmi, Qëndrueshmëria*, por kjo dinamikë shprehet edhe me tregues të tjerë siç janë, faktorët *kulturorë, struktura e personalitetit* të personave që komunikojnë, *ambienti* etj. Përsa i përket llojeve të komunikimit, dy janë më të njohurat:

- komunikimi *verbal* (shprehje gojore e mendimeve, ndjenjave, ideve) si edhe
- komunikimi *jo verbal* (gjuha e xhesteve).

Dëgjimi aktiv

Një aspekt shumë i rëndësishëm i komunikimit të suksesshëm, është të kuptuarit që çfarë po thotë ose po përpiqet të thotë personi tjetër. Është e qartë që të kuptojmë duhet së pari të aftësohemi të dëgjojmë. Teknika e të dëgjuarit aktiv i lejon atij që flet, të kuptojë që të tjerët

⁴ Strategjia kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm 2014 - 2020

po e dëgjojnë dhe po e kuptojnë. Kur personi ndjen që është keq kuptuar, ai/ajo zakonisht përgjigjet me zemërim dhe shqetësim. Nga ana tjetër kur njerëzit e dinë që të tjerët i perceptojnë pozicionet e tyre me vëmendjen e duhur, ata ka shumë të ngjarë të ndjehen të pranuar dhe komfort. Në këtë kontekst ata janë më të prirur të marrin një pozicion objektiv dhe të tregohen të gatshëm për të modifikuar pozicionet e tyre aktuale.

Kur njerëzit e ndjejnë që po kuptohen dhe po dëgohen, ata i shprehin më plotësisht mendimet e tyre. Kjo gjë e lejon mediatorin të marrë më shumë informacion nga folësi dhe ky informacion mund të jetë i nevojshëm në përpjekjen për të zgjidhur konfliktin.

Mos harroni se kuptimi i përmbajtjes si dhe e mënyrës se si ndjehet personi i lejon folësit të kuptojë që ju e keni dëgjuar me vëmendje dhe e keni kuptuar. Dëgjimi me vëmendje si dhe të kuptuarit, nuk do të thotë se aproveni ato që thuhet.

Perifrazimi

Është riformulimi me fjalët tuaja të idesë kryesore të folësit, me qëllim:

- Ofrimin e ndihmës në sqarimin e çështjeve që folësi ka hasur
- Modelimin e një mënyre konstruktive të kuptuarit në lidhje me problemin në fjalë
- Të tregosh që e ke vëmendjen dhe kupton ato që u thanë
- Të tregosh se je i interesuar për ato që ka për të thënë bashkëbiseduesi
- Të lejon të kontrollosh a i kuptove mirë ato që ka ndërmend bashkëbiseduesi (në qoftë se i kuptove keq bashkëbiseduesi mund të të korrigojë dhe të shprehet më qartë)
- Të jap mundësi që të vësh në vijë (të sistemosh në kokë) ato që të tha bashkëbiseduesi
- Të jap më shumë kohë që të formosh përgjigjen

Mos gjykoni

- Dëgjoni mesazhet jo verbale me të njëjtën vëmendje si dhe ato verbale. A e mbështet komunikimi joverbal komunikimin verbal?
- Lëruni kohën e duhur personave për të shprehur ato që duan.
- Mbani nën kontroll ndjenjat tuaja, sepse ndjenjat e frikës, zemërimit, shqetësimit mund t'ju pengojnë seriozisht të dëgjoni dhe të kuptoni ato që thuhet.
- Reagoni ndaj ideve dhe jo ndaj personave. Edhe në qoftë se ju nuk e pëlqeni një poze ose nuk pëlqeni mënyrën se si flet personi, idetë e tij/saj mund të jenë të vlefshme për procesin.

- Shmangni supozimet. Njerëzit përdorin fjalë të tjera, kanë xheste të tjera dhe mund ti interpretojnë faktet në mënyrë të ndryshme nga e juaja.
- Bëni pyetje në rast se ju nuk kuptoni ose keni nevojë për më tepër sqarim.

Drejtimi i pyetjeve

Mënyra se si drejtohet një pyetje (toni i zërit nuk duhet të nënvleftësohet) është më e rëndësishme se sa përmbajtja e saj.

Pyetje të hapura

Janë shumë të rëndësishme për të kuptuar se si palët e shohin situatën. Ato mund të jenë:

- Si e shihni këtë problem?
- Cila është çështja në mes jush?
- A mund të më tregoni historinë sipas pikëpamjes tuaj?
- Çfarë tjetër? Po pastaj.....?

Ka shumë avantazhe për pyetjet e hapura, sidomos në fazat e para të sesionit.

- Personat do të ndjehen më komfort të tregojnë historinë pa u ndërprerë dhe kjo do të ndihmojë në vendosjen e raportit me ta.
- Personat duke e treguar historinë sipas pikëpamjeve të tyre, do të ndihmojnë për të kuptuar kontekstin.
- Personi do të flasë më lirshëm duke ndjekur rrjedhën e logjikës dhe mendimeve të veta.
- Informacioni që do të merret do të eliminojë nevojën për të drejtuar shumë pyetje. Kjo gjë e bën më të lehtë dhe më informale mënyrën e kontaktit në mes të mediatorit dhe palëve.

Pyetjet e drejtpërdrejta

- Janë shumë të vlefshme kur kërkohet të merret informacion specifik
- Pyesni vetëm për informacion esencial.
- Mos e teproni me shumë pyetje, sepse palët do të ndihen si në intervistë.
- Disa pyetje të drejtë përdrejta pas vendosjes së raportit tregojnë një interesim të sinqertë dhe ka mundësi të pranohen mirë nga folësit
- Do të ishte e rëndësishme të drejtohej pyetja në këtë mënyrë: “Në lidhje me këtë unë do të doja të dija disa fakte direkte, kështu që mbase do të më duhet të drejtoj disa pyetje specifike”.

Shmangni pyetjet që fillojnë me “pse” kur është e mundshme

Shpesh ato tingëllojnë si akuzuese dhe duket sikur nxisin sjelljen mbrojtëse dhe justifikime nga palët. Psh: Duhet të ketë patur një shkak që ju nuk e keni paguar qeranë dhe jo “pse se keni paguar qeranë?”

Pyetjet që kërkojnë si përgjigje një “po” ose “jo” duhen të drejtohen me kujdes.

Kur drejtoni pyetje që kërkojnë si përgjigje një “po” ose “jo” në përgjithësi merni një përgjigje të limituar dhe shumë pak informacion. Por ka edhe situata në të cilat pyetjet që kërkojnë përgjigje “po” “jo” janë të nevojshme. Për shembull, kur ju kërkon të drejtoni personat drejt zgjidhjes, ju mund të pyesni një seri pyetjesh që kërkojnë përgjigje “po” nga njëra apo të dyja palët. Këto pyetje kanë efektin e duhur në qartësimin e të kuptuarit të dy palëve dhe e përmirësojnë klimen e të rënit dakort.

Ndërtimi i një strategjie komunikimi dhe edukimi kundër ekstremizmit të dhunshëm

Tregimi i historive vizuale

- Foto
- Video
- Grafikë
- Grafikë informues

Video është bërë një pjesë integrale e përvojës së përdoruesve të internetit online, dhe YouTube është një nga rrjetet që ka numrin më të madh të postimit dhe shikueshmërisë së videove. YouTube lejon krijimin e një kanali falas i cili mundëson mbajtjen në të njëjtin vend të të gjitha videove. Krijoni **video të shkurtra** që përmbajnë mesazhin që doni të përcillni tek audienca juaj (videot mund të krijohen pa kosto nëpërmjet filmimeve të bëra me pajisje mobile dhe editimin e tyre).

ORGANIZIMI I ORËVE PËR TEMËN “EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE RADIKALIZMI”

Rezultatet e pritshme nga trajtimi i kësaj teme.

Nxënësi:

- zhvillon aftësitë e të menduarit dhe të analizës në mënyrë kritike;
- është i vetëdijshëm për llojet e stereotipave, të paragjykimeve dhe perceptimeve paraprake dhe për ndikimin e tyre;


- bën dallimin ndërmjet faktit dhe opinionit dhe për të dyshuar burimet e tyre;
- informohet për format e ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm dhe për çështje të tjera globale;
- përjeton ndjenjën e përkatësisë në një grup shoqëror, me vlera e përgjegjësi të përbashkëta, të mbështetura tek të drejtat e njeriut;
- respekton diversitetin;
- dallon emocionet që përjetohe nga persona të tjerë
- interesohet për të mënyrën e jetesës dhe kulturën e personave të ndryshëm;
- zhvillon kompetencat ndërkulturore;
- dëgjon me respekt pikëpamjet e ndryshme; shpreh mendimet vetjake dhe i vlerëson të dyja;
- vepron me efektivitet dhe përgjegjësi gjatë diskutimit;
- shprehet me vetëbesim dhe trajton konfliktin në mënyrë pozitive;
- shpreh dëshirën për të marrë veprime të përgjegjshme.

Metodat dhe teknikat mësimore: stuhi mendimi, kllaster, lojë me role, bashkëbisedim, ese.

Koha mësimore: 2 orë mësimi (45 minuta+45 minuta).

Hapi i parë

Mësuesi organizon një stuhi mendimi për ekstremizmin e dhunshëm. Nxënësit shprehin çfarë kanë lexuar ose kanë dëgjuar rreth ekstremizmit të dhunshëm. Më pas mësues plotëson në tabelë një kllaster për **simptomat e para të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit**.



Hapi i dytë

Bashkëbisedim: për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë lidhjet ndërmjet sfidave lokale dhe globale, si dhe rreziqet reale dhe pasojat e ekstremizmit të dhunshëm, mësuesi nxit nxënësit në një bashkëbisedim për shkaqet lokale të ekstremizmit dhe për nxitësit e ekstremizmit.

Disa nga çështjet që mund të mbahen parasysht gjatë bashkëbisedimit:

Kuptimi i larmisë shoqërore, kulturore, etnike dhe fetare të kontekstit lokal.

1. Përfshirja në diskutim e këndvështrimeve të pakicave ose, të paktën, sigurimi i përfaqësimit të pikëpamjeve të tyre, në mënyrë të tillë, që të rinjve t'u mundësohet njohja me larminë e trajtimit të çështjeve.
2. Qartësia për rolin e mësuesit si moderator (zë objektiv, “avokati i djallit”, lehtësues i paanshëm etj.).
3. Përcaktimi i kohës së diskutimit, pasi çështjet e debatueshme nuk duhet të diskutohen kuturu.

Hapi tretë

Lojë me role: Roli i komunitetit, i familjes, i arsimit dhe i medias

Mësuesi i ndan nxënësit në grupe me nga 8 anëtarë secili. Brenda grupit formohen çiftet. Një çift do të luajë rolin e komunitetit, tjetri të familjes, i treti të arsimit dhe i katërti të medias. Pasi do të bëjnë një parapërgatitje, grupet do të dalin në panel me radhë dhe do të shprehin pikëpamjet e tyre për misionin që i takon të përmbushë secili nga këta katër “aktorë” për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin.

Në përfundim të lojës në role do të arrihet në përfundimet se:

1. Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm përmes edukimit duhet të jetë pjesë e një përpjekjeje më të gjerë parandaluese, në të cilën të përfshihet familja, shkolla, komuniteti dhe media.
2. Ndërtimi i rrjeteve të mbështetjes dhe kujdesit, të cilat i shtrijnë më tej këto fusha, rrit shanset e një ndikimi pozitiv dhe zhvillon mirëqenien e komunitetit, pa u përqendruar vetëm te mbikëqyrja.

Hapi katërt

Ese: Si do të sillesh unë, nëse do të kisha pranë një individ ekstremist të dhunshëm.

Mësuesi u lë nxënësve kohën e mjaftueshme për të shkruar esenë me deri 500 fjalë. Kjo detyrë mund t'u jepet nxënësve për t'u mbaruar në shtëpi dhe për ta paraqitur orën e ardhshme.

Hapi i pestë

Mësuesi kërkon nga nxënësit që ata të lexojnë esetë e përfunduara në shtëpi. Ai do të orientojë nxënësit që të mbajnë shënime gjatë leximit të eseve dhe, më pas, do të kërkojë që nxënësit të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë për problematika që do të shtrohen.

Këtu është momenti që, pas diskutimit rreth ekstremizmit të dhunshëm me nxënësit, mësuesi duhet të sigurohet se nuk ka keqkuptime dhe tensione të pazgjidhura ndërmjet nxënësve. Kjo nënkupton gjetjen e kohës për të analizuar të gjithë së bashku se çfarë është kuptuar dhe mësuar nga shkëmbimi i ideve. Ky është çasti i përshtatshëm edhe për të zgjidhur çështjet e pasqaruara, të cilat mund të kërkojnë veprimtari të thelluara dhe hapa të mëtejshëm.

Hapi i gjashtë

Pyetje përmbledhëse

Mësuesi, bazuar në gjithë hapat e ndjekur duke filluar qysh në orën e parë, harton një listë me pyetje përmbledhëse, të cilat i paraqet para nxënësve të klasës së tij dhe rihap një diskutim të lirë. Pyetjet e mundshme janë:

1. Çfarë mësuar?
2. A keni pyetje për ndonjë çështje tjetër?
3. A jemi më pranë të kuptuarit të proceseve që çojnë në radikalizimin e të rinjve?
4. Çfarë na duhet të dimë tjetër për ta kuptuar më mirë ekstremizmin e dhunshëm?
5. Si mund ta vijojmë diskutimin?

Mund të ndodhë që diskutimi të jetë i nxehtë. Në këtë rast, mësuesi bën mirë që të takohet me secilin nxënës individualisht për ta falënderuar për pjesëmarrjen në diskutim. Në këtë mënyrë, mësuesi e siguron çdo nxënës që ai ka të drejtë të shprehë pikëpamjet e veta lirshëm për aq kohë sa i respektojnë ato nxënësit e tjerë.

Hapi i shtatë

Pyetje pasuese

Pa u mjaftuar me debatin e zhvilluar në hapin e dytë me pyetjet përmbledhëse, mësuesi mund t'i ndihmojë nxënësit për të reflektuar për situatën. Për këtë, ai shtron për diskutim dy pyetjet që vijojnë:

1. Si tregohet respekt për idenë e tjetrit, edhe në rast se nuk je dakord me të?
2. A ka ndonjë gjë që do ta bëje ndryshe pas këtij diskutimi?

Hapi i tetë

Panelet e diskutimit

Meqenëse nxënësit kanë tashmë njohuri paraprake për ekstremizmin e dhunshëm, mësuesi mund të organizojë këtë veprimtari e cila ka për qëllim të aftësohen nxënësit për të shprehur qëndrime të ndryshme nga tyret.

Kjo veprimtari fillohet duke zgjedhur nxënës vullnetarë për të marrë përsipër rolin e panelistëve në një “program televiziv” që i kushtohet ekstremizmit të dhunshëm. Në këtë program, nxënësit do të flasin për ekstremizmin sipas këndvështrimit të tyre. Normalisht, nxënësve mund t’u caktohet roli që mban qëndrim të kundërt me pikëpamjet e tyre personale rreth temës. Veprimtaria fillon me nxënësit panelistë, të cilët fillimisht prezantohen dhe më pas vijojnë me shprehjen e qëndrimeve përkatëse. Klasa u bën pyetje panelistëve, ndërsa mësuesi shërben si moderator.

Shtojca 1

DEKLARATA E PËRGJITHSHME MBI TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 1.

Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vëllazërimi.

Neni 2.

Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh për sa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër. Asnjë dallim nuk do të bëhet në bazë të statusit politik, juridik ose ndërkombëtar të shtetit ose vendit të cilit i përket çdo njeri, qoftë kur shteti ose vendi është i pavarur, qoftë nën kujdestari, qoftë jo vetëqeverisës ose që gjendet në çfarëdo kushtesh të tjera të kufizimit të sovranitetit.

Neni 3.

Gjithkush ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë sigurimin vetjak.

Neni 4.

Asnjeri nuk duhet të mbahet si skllav ose çifçi; skllavëria dhe tregtia e skllavëve janë të ndaluara në të gjitha format.

Neni 5.

Asnjeri nuk duhet t'i nënshtrohet mundimit, veprimit ose dënimit të egër, jonjerëzor ose poshtëruës.

Neni 6.

Gjithkush ka të drejtë që t'i njihet kudo personaliteti juridik.

Neni 7.

Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t'u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cënon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë.

Neni 8.

Gjithkush ka të drejtë për mjete juridike të frytshme para gjykatave kompetente kombëtare për veprimet me të cilat shkelen të drejtat themelore të garantuara nga kushtetuta ose ligjet.

Neni 9.

Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet arbitrarisht arrestimit, ndalimit ose internimit.

Neni 10.

Gjithkush gëzon njëlloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale.

Neni 11.

Kushdo që është i akuzuar për një veprë penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm deri sa të vërtetohet fajësia në bazë të ligjit dhe në një proces publik në të cilin ka pasur të gjitha garancitë e duhura për mbrojtjen e vet. Asnjëri nuk duhet të dënohet për veprime ose mosveprime të cilat nuk përbëjnë një veprë penale, sipas ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare, në kohën kur janë kryer. Gjithashtu nuk mund të vendoset një dënim më i rëndë nga ai që ka qenë zbatuar në kohën kur është kryer vepra penale.

Neni 12.

Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare në jetën, familjen, banesën ose korrespondencën vetjake, si dhe sulmeve kundër nderit dhe prestigjit personal. Gjithkush ka të drejtën të mbrohet nga ligji kundër ndërhyrjeve ose sulmeve të tilla.

Neni 13.

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së qarkullimit dhe banimit brenda kufijve të çdo shteti. Gjithkush ka të drejtë të largohet nga cilido vend qoftë, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehet në vendin e vet.

Neni 14.

Gjithkush ka të drejtë të kërkojë dhe gëzojë në vende të tjera azil nga ndjekjet. Këtë të drejtë nuk mund ta gëzojë askush në rast se ndiqet për krime jopolitike ose për vepra në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

Neni 15.

Gjithkush ka të drejtën e një shtetësie. Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga shtetësia e tij si dhe as nga e drejta që të ndërrojë shtetësinë.

Neni 16.

Burrat dhe gratë në moshë të pjekur kanë të drejtë të lidhin martesë dhe formojnë familje, pa kurrfarë kufizimi për sa i përket racës, shtetësisë ose besimit. Ata kanë të drejta të barabarta si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurorëzimi. Martesa duhet të lidhet vetëm me

pëlqimin plotësisht të lirë të personave që do të martohen. Familja është bërthama e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti.

Neni 17.

Gjithkush ka të drejtën të ketë pasuri, si vetëm ashtu edhe në bashkësi me të tjerët. Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij.

Neni 18.

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit; kjo e drejtë përfshin lirinë e ndryshimit të besimit ose bindjeve dhe lirinë që njeriu, qoftë vetë ose në bashkësi me të tjerët, të shfaqë publikisht ose privatisht, besimin ose bindjen e vet me anë të dhënies së mësimëve, kryerjes së kultit dhe ceremonive fetare.

Neni 19.

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjete qoftë, pa marrë parasysh kufijtë.

Neni 20.

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mbledhjes dhe bashkimit paqësor. Asnjëri nuk duhet të detyrohet të bëjë pjesë në ndonjë bashkim.

Neni 21.

Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht. Gjithkush ka njëllë të drejtë të hyjë në shërbimet publike në vendin e vet.

Vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhje periodike dhe të lira të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe votimi i barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë.

Neni 22.

Si anëtar i shoqërisë, gjithkush ka të drejtën e sigurimit shoqëror dhe realizimit të të drejtave ekonomike, sociale, kulturore të domosdoshme për dinjitetin e vet dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit, me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe mundësitë e çdo shteti.

Neni 23.

Gjithkush ka të drejtën për punë, të zgjedhë lirisht profesionin, të ketë kushte të favorshme pune dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia. Gjithkush, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të njëjtë të marrë rrogë të njëjtë. Gjithkush që punon ka të drejtën për një shpërblim të drejtë dhe të favorshëm, në mënyrë që t'i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor dhe, në qoftë se do të jetë e nevojshme ky shpërblim të plotësohet edhe me mjete të tjera të sigurimit shoqëror.

Gjithkush ka të drejtë të formojë sindikatë dhe të bëjë pjesë në të për mbrojtjen e interesave të veta.

Neni 24.

Gjithkush ka të drejtë për pushim dhe kohë të lirë, duke përfshirë kufizimin e arsyeshëm të orarit të punës dhe pushimin e paguar periodik.

Neni 25.

Gjithkush ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm i cili t'i përgjigjet shëndetit dhe jetës së përshtatshme si të atij personalisht, ashtu edhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banesën, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si edhe të drejtën për të qenë i siguar në rast sëmundjeje, papunësie, pleqërie dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë për shkak të rrethanave të pavarura nga vullneti i tij. Nënata dhe fëmijët kanë nevojë për kujdes dhe ndihmë të posaçme. Të gjithë fëmijët, të lindur brenda ose jashtë martesë, gëzojnë të njëjtat mbrojtje sociale.

Neni 26.

Gjithkush ka të drejtën e shkollimit. Arsimi duhet të jetë falas, të paktën në shkollat fillore dhe të ulta. Arsimi fillor është i detyrueshëm. Arsimi teknik dhe profesional duhet të zgjerohet e arsimi i lartë duhet t'u bëhet i mundshëm të gjithëve në bazë të aftësisë. Arsimi duhet të drejtohet nga zhvillimi i plotë i personalitetit të njeriut dhe nga forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ai duhet të nxisë kuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjithë popujve, grupeve të racave dhe besimeve, si dhe veprimtarinë e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes. Të drejtën për të zgjedhur llojin e arsimit për fëmijët e tyre e kanë në radhë të parë prindërit.

Neni 27.

Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore të bashkësisë, të gëzojë artet dhe të përfitojë nga përparimi shkencor dhe dobitë e tij. Gjithkush ka të drejtë të mbrojë interesat morale dhe materiale, që rrjedhin nga çdo krijimtari shkencore, letrare dhe artistike, autor i të cilave është ai vetë.

Neni 28.

Gjithkush ka të drejtë për një rend shoqëror dhe ndërkombëtar në të cilin mund të realizohen plotësisht të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë.

Neni 29.

Gjithkush ka detyrime vetëm ndaj asaj bashkësie në të cilën është i mundur zhvillimi i lirë dhe i plotë i personalitetit të tij. Në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të veta, gjithkush do t'u nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve të cilat janë parashikuar me ligj, ekskluzivisht me qëllim që të sigurohet njohja dhe respektimi i nevojshëm i të drejtave dhe lirive të të tjerëve e që të plotësohen kërkesat e drejta të moralit, rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme në shoqërinë demokratike.

Neni 30.

Asgjë në këtë Deklaratë nuk mund të interpretohet si e drejtë e një shteti, grupi apo personi për të kryer çfarëdo veprimtari ose për të bërë një akt drejtuar kundër çdo të drejte ose lirie të shpallur në këtë Deklaratë.